



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Shkarkohet** Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Posta e Kosovës" Sh.A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
 - 2.1. Mentor Arifaj, kryesues dhe drejtor;
 - 2.2. Kujtim Shala, drejtor;
 - 2.3. Sajmie Thaçi, drejtore, dhe
 - 2.4. Blerton Abazi, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Posta e Kosovës" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	26.2.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për shkakimin e bordit të drejtorëve dhe emërimin e bordit të përkohshëm të drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore “Posta e Kosovës” Sh.A.

I nderuar Kryeministër Kurti,
të nderuar zëvendëskryeministra Hoti dhe Abazi,
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, i propozoj Qeverisë ta shkarkojë bordin e drejtorëve dhe të emërojë një bord të përkohshëm në ndërmarrjen publike “Posta e Kosovës”. Këtë propozim e jap mbështetur në Kushtetutë dhe në Ligjin për ndërmarrjet publike.¹

Sipas ligjit, Qeveria duhet t’i shkarkojë drejtorët kur ka “arsye për të besuar” se kanë shkelur detyrat fiduciare.² Termi *detyrë fiduciare* përkufizohet si detyra për të vepruar me ndershmërinë e besnikërinë më të lartë ndaj ndërmarrjes dhe në interesin më të mirë të saj.³

Në raportin e vet mbi Postën për vitin 2018, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë opinion të kundërt, që domethënë se “pasqyrat vjetore financiare [të Postës] nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale”.⁴ Tutje, ZKA thotë se “Menaxhmenti i NP Posta e Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare” dhe se “Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar”.⁵

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119.9; Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009 (LNP), neni 5.1.

2 LNP, neni 19.3.

3 Termi është huazuar nga anglishtja. Shih zërin «*fiduciary duty*» në fjalorin juridik *Black’s Law Dictionary*, 9th ed., f. 581.

4 Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), Raporti i auditimit të ndërmarrjes publike “Posta e Kosovës” për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2018, botuar në qershor 2019, f. 8.

5 ZKA, sipër, f. 18.

Por Bordi i Postës nuk ka marrë masa të duhura ndaj menaxhmentit lidhur me pasqyrat e rreme financiare. Tre nga gjashtë drejtorët madje, përfshi kryesuesin e Bordit, kanë qenë në detyrë edhe në kohën kur janë përmbyllur pasqyrat financiare, dhe kanë dështuar të sigurojnë raportimin e saktë. Kësisoj, Qeveria ka arsye të besojë se drejtorët kanë shkelur detyrat fiduciare, dhe duhet të shkarkohen.

Pas shkarkimit, Qeveria duhet të emërojë sa më shpejt një bord të përkohshëm.⁶ Kandidatët që kemi paraqitur në propozim-vendim janë ekspertë të qeverisjes korporative dhe të lëmenjve në të cilët operon ndërmarrja. Andaj e ftoj Qeverinë t'i emërojë si drejtorë të përkohshëm.

Rozeta HAJDARI

Ministre

⁶ LNP, neni 43.